European Union Kosovo

ERAC
EQUAL RIGHTS FOR ALL COALITION

PËRFAQËSIMI I KOMUNITETIT SERB TË KOSOVËS NË PROFESIONET E LIRA LIGJORE NË KOSOVË

Mirënjohje

Anëtarët e Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të dhënë informacione e të dhëna të paçmueshme për këtë raport.

OJQ-ja udhëheqëse për publikimin e Raportit

ECMI Kosovo (www.ecmikosovo.org)
ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

Rruga "Nëna Terezë" Nr. 20, Apt. 5,
10000 Prishtinë—Kosovë,
Tel. +383 (0) 38 224 473

Rruga "Kralja Petra" 183a
38220 Mitrovicë e Veriut—Kosovë

Koalicioni për të drejta të barabarta për të gjithë - ERAC

ERAC mbledh së bashku shtatë (7) OJQ që punojnë ***në fushën e sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore***, të cilat punojnë së bashku me ***19 OJQ***, me fokus në ngritjen e një rrjeti të qëndrueshëm tëOJQ-ve, që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të margjinalizuara. Fokusi specifik i projektit janë këto grupe: ***komunitetet jo-shumicë, gratë, rinia, dhe komuniteti LGBT***. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi gjeneron shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve (duke përfshirë përvojën në çështjet institucionale), për të forcuar kapacitetet e tyre për avokim me institucionet qendrore dhe komunale, dhe për të rritur dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarë të ERAC-ut janë organizatat si më poshtë:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë –Organizatë lider e Koalicionit;
- Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore– anëtare e Koalicionit;
- Qendra për Barazi dhe Liri të komunitetit LGBT në Kosovë (CEL) – anëtare e Koalicionit;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore - anëtare e Koalicionit;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - anëtare e Koalicionit;
- Kosovo 2.0 – anëtare e Koalicionit;
- Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) - anëtare e Koalicionit

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosovo dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

E drejta e autorit

© Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC), prill 2019. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ERAC-ut.

European Union Kosovo

ERAC
EQUAL RIGHTS FOR ALL COALITION

PËRFAQËSIMI I KOMUNITETIT SERB TË KOSOVËS NË PROFESIONET E LIRA LIGJORE NË KOSOVË

HISTORIKU

Në Kosovë ekzistojnë pesë profesione të lira ligjore, si avokatët, noterët, përmbaruesit privat (PP), ndërmjetësuesit dhe administratorët e falimentimit. Këto profesione rregullohen nga qeveria, përkatësisht nga Ministria e Drejtësisë (MD). MD-ja është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit të nevojshëm për rregullimin e këtyre profesioneve dhe luan një rol kyç në garantimin e funksionimit të sistemit të profesioneve juridike.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Drejtësisë (Departamenti i Profesioneve të Lira) sa i përket katër prej pesë profesioneve të lira (PLJ-ve) përkatësisht noterëve, përmbaruesve privatë, ndërmjetësuesve dhe administratorëve të falimentimit janë që të propozojnë, hartojnë dhe sigurojnë zbatimin e legjislacionit në fushën e noterisë, përmbarimit, jurisprudencës (Provimit të Jurisprudencës), ndërmjetësimit dhe falimentimit në bashkëpunim me institucionet përkatëse. MD gjithashtu është përgjegjëse për licencimin dhe monitorimin (mbikëqyrjen) e punës së noterëve, përmbaruesve privatë, ndërmjetësuesve dhe administratorëve të falimentimit; të përgatisë raporte analitike, si dhe të sigurojë informacione mbi punën e noterëve, përmbaruesve privatë dhe ndërmjetësuesve; të sigurojë mbështetje për përgatitjen e manualeve dhe standardeve nga Oda e Noterëve dhe Oda e Përmbaruesve Privat; të ofrojë mbështetje administrative për komisionet testuese dhe licencuese të noterëve, përmbaruesve privatë, zëvendës të përmbaruesve private dhe ndërmjetësuesve. Kompetencat e tjera në monitorim përfshijnë përgatitjen e dokumentacionit për shqyrtimin e kërkesave në përputhje me legjislacionin përkatës; të mbajë regjistrin e noterëve, të përmbaruesve privatë dhe zëvendës PP-ve, Ndërmjetësve dhe Administratorëve të Falimentimit; si dhe mirëmbajtjen e shënimeve rreth personave që kanë kaluar provimin e noterit, dhe provimin e PP, mbanë evidencë për kandidatët që kanë aplikuar për provimin e Jurisprudencës dhe kandidatët që kanë kaluar këtë provim, duke marrë parasysh që provimi i jurisprudencës është i nevojshëm edhe për profesionet e avokatëve dhe përmbaruesve privatë.[1]

Për më tepër, sipas Rregullores së ndryshuar të Qeverisë për organizimin e brendshëm të MD-së[2] në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë do të themelohet një Divizion i ri, përkatësisht Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së punëve të përmbaruesve privatë, noterëve dhe ndërmjetësve. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij divizioni do jenë si më poshtë: 1) kryen mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës

1 Rregullorja QRK Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshme të Ministrisë së Drejtësisë, u miratua në mbledhjen 156 të qeverisë së Kosovës me vendimin nr. 01/156 datë 13.11.2013 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10360, Rregullorja QRK - Nr.12 / 2018 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores QRK -Nr. 31/2013 Për Organizatën e Brendshme të Ministrisë së Drejtësisë https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/C9444161-1189-4794-AEEA-A69FD0181A19.pdf

2 Rregullore Qrk – nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Qrk – nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/C9444161-1189-4794-AEEA-A69FD0181A19.pdf

së përmbaruesve privat, noterëve dhe ndërmjetësuesve në pajtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore, Ligjin për Noterinë dhe Ligjin për Ndërmjetësim 2) përgatit procesverbal lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës të Profesioneve të Lira. 3) përgatit raport dhe jep rekomandime lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës të Profesioneve të Lira. 4) kryen punë të tjera në pajtim m legjislacionin në fuqi.

Mbikëqyrja e Legalitetit të Punës së këtyre 3 profesioneve do të bëhet në pajtim me Ligjin e Procedurës Përmbarimore, Ligjin për Noterinë dhe Ligjin për Ndërmjetësimin dhe aktet nënligjore përkatëse të tyre.

Noterët

Shërbimi i noterisë është shërbim publik i cili ushtrohet nga noterët e licencuar nga Ministri i Drejtësisë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Noterinë[3]. Ky ligj rregullon organizimin dhe kriteret për ushtrimin e profesionit të noterit, administrimin e provimit të noterit, përcakton kompetencat e noterit dhe çështje të tjera që lidhen me ushtrimin e detyrave të noterit në territorin e Kosovës. Noterët janë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e shërbimeve të noterit dhe në ushtrimin e funksioneve noteriale të përcaktuara me ligj.

Pas emërimit nga Ministri i Drejtësisë, noteri, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, është i detyruar të bëjë betimin para Ministrit, Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryesuesit të Odës së Noterëve. Pas betimit, individi i autorizuar nga Ministri i paraqet noterit aktin e licencimit (një kopje i dërgohet Dhomës). Përmbajtja dhe forma e aktit të licencimit përcaktohet nga Ministri. Ministria dhe Oda mbajnë regjistrin[4] e të gjithë noterëve të licencuar. Bazuar në të dhënat nga Oda e Noterëve, numri i përgjithshëm aktual i noterëve në Kosovë është shtatëdhjetë (70), nga të cilat vetëm një (1) noter i përket komunitetit serb në Kosovë. Përfaqësimi shumë i ulët i Serbëve të Kosovës në këtë profesion pengon qasjen në drejtësi për këtë komunitet.

Në korrik 2019 Ministria e Drejtësisë në një komunikim për mediat theksoi se sipas Ligjit të ri për Noterinë i cili hyri në fuqi në fillim të vitit 2018[5] ata do të fillojnë procesin e rekrutimit të noterëve. Ministria, gjithashtu, shtoi se për të kapërcyer sfidat aktuale, Ligji i ri për Noterinë parashikon, ndër të tjera, rritjen e numrit të noterëve sipas formulës së re 1 noter në 10 mijë banorë.[6] Si rezultat i këtij procesi, është hapur një konkurs publik për zgjedhjen e noterëve ku Ministria ka hapur 79 vende të lira për noterët, dhe mes tyre janë komunat jo-shumicë.[7] Shpresojmë që kjo do të rrisë numrin e noterëve Serbë të Kosovës dhe do të përmirësojë qasjen në drejtësi.


[3] Ligji Nr. 06 / L –010 Për Noterinë në Gazetën Zyrtare të Kosovës / Nr. 23/26 dhjetor 2018 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18334

[4] Regjistri i Noterëve http://noteria-ks.org/noteret/

[5] Ligji Nr. 06 / L –010 Për Noterinë, Gazeta Zyrtare e Kosovës / Nr. 23/26 Dhjetor 2018, Prishtinëhttps://md.rks-gov.net/desk/inc/media/20765567-A382-4FED-A7CD-AB9ED5A1E0F9.pdf

[6] https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,2047

[7] Vendimet e Ministrisë së Drejtësisë për Noteritë https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,42



Përmbaruesit Privatë

Sistemi i përmbarimit privat rregullohet me Ligjin për procedurën përmbarimore[8]. Përmbaruesit privatë dhe Dhoma e tyre monitorohen nga Departamenti i MD për Profesione të Lira në Ministrinë e Drejtësisë. Legaliteti i punës së përmbaruesve privatë mbikëqyret nga Divizioni i MD për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së noterëve, PP-ve dhe ndërmjetësve. Sipas këtij ligji, "Përmbaruesi privatë" është personi fizik i emëruar nga Ministri i Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore për ekzekutimin/përmbarimin e autorizimeve publike, të cilit i është besuar ekzekutimi i zbatimit të lejuar dhe ekzekutimi i veprimeve përmbarimore. Përmbaruesi privatë është i pavarur dhe kryen funksione vetëm në përputhje me ligjin. Selia e Përmbaruesit Privat ndodhet brenda territorit të Gjykatës Themelore për të cilën ai është emëruar.

Në mënyrë që ky shërbim të jetë konkurrues dhe cilësor, numri i përmbaruesve privatë përcaktohet nga Ministri në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën e përmbarimit. Për territorin e Gjykatës Themelore, pozicioni i një përmbaruesi privat, si rregull, është vendosur në njëzet e pesë mijë (25,000) banorë. Sipas të dhënave të publikuara nga Dhoma[9]dhe të dhënat e publikuara nga Ministria[10], numri i përgjithshëm i përmbaruesve privat në Kosovë është dyzet e dy (42). Nuk ka ndonjë anëtar nga komunitetit serb i Kosovës të përfaqësuar në këtë profesion aktualisht. Kjo thjesht tregon se qeveria e Kosovës duhet të punojë më shumë për të arritur këtë komunitet dhe për të siguruar që ata janë pjesë e sistemit.

Ndërmjetësit

[8] Ligji Nr. 04 / L-139on Procedura e përmbarimit Gazeta Zyrtare e Kosovës / Nr. 3/31 janar 2013 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870, i ndryshuar dhe i plotësuar në 2017 me Ligji Nr. 05 / L-118 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04 / L-139 Për Procedurën e përmbarimit https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/69AEC87B-6E47-4CC0-A103-50E80C37011E.pdf

[9] Regjistri i Odës së Përmbaruesve Privatë http://opk-rks.org/permbaruesit/#1500369839294-b52c003d-3935

[10] Regjistri i Përmbaruesve Privatë i Ministrisë së Drejtësisë https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/988243B5-9ABF-45CA-B3DB-7F53A905C237.pdf

Ligji i Ndërmjetësimit[11] rregullon funksionimin, procedurën dhe organizimin e ndërmjetësimit, si dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësve në mënyrë që të lehtësojë qasjen në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe të promovojë zgjidhjen miqësore të tyre. Sipas ligjit, një "ndërmjetës" është personi i tretë, i paanshëm dhe i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, dhe që ka zgjedhur të ndërmjetësojë midis palëve për të zgjidhur mosmarrëveshjet në përputhje me parimet e ndërmjetësimit. Ministri i Drejtësisë është përgjegjës për certifikimin e ndërmjetësve. Ministria e Drejtësisë dhe Oda e Ndërmjetësve mbajnë regjistrin publik[12] e të gjithë ndërmjetësve të licencuar në Kosovë. Sipas regjistrit të publikuar, numri i përgjithshëm i ndërmjetësve që praktikojnë në territorin e Kosovës është njëqind e tetëdhjetë e nëntë (189), nga të cilët nëntëmbëdhjetë (19) i përkasin komunitetit serb të Kosovës.



Administratorët e falimentimit

Kriteret për kompetencat e administratorëve përcaktohen në nenin 86 të ligjit të falimentimit[13]. Sipas Kapitullit VII të Ligjit të Falimentimit, administratorët janë persona të caktuar si përfaqësues të pasurive të falimentimit. MD-ja mban regjistrin e administratorëve falimentues të licencuar. Numri i përgjithshëm i Administratorëve Falimentues të licencuar në territorin e Kosovës është tetëmbëdhjetë (18), dhe nuk ka ndonjë anëtar nga komuniteti Serb i Kosovës të përfaqësuar në këtë profesion.


[11] Ligji Nr.06 / L –009 Për Ndërmjetësimin Gazeta Zyrtare e Kosovës / Nr 14/20 Gusht 2018 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17769

[12] Regjistri i Ndërmjetësve të Ministrisë së Drejtësisë https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/0284D2EC-42BD-43DC-AE73-76C1DC8E74DC.pdf

[13] Ligji Nr. 05 / L - 083 Për Falimentimin Gazeta Zyrtare e Kosovës / Nr. 23/7 korrik 2016 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12664

Avokatia

Ligji për Avokatinë[14] rregullon kushtet për ushtrimin e ligjit për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e avokatëve dhe praktikantëve si dhe organizimin dhe punën e Odës së Avokatëve të Kosovës. Sipas këtij ligji, avokat konsiderohet një person i regjistruar në Odën, i cili ka bërë betim dhe merret me avokati. Sipas regjistrit të publikuar të Odës [15] në faqen e tyre të internetit, numri i përgjithshëm i avokatëve në Kosovë është nëntëqind e tetëmbëdhjetë (918), nga të cilët tridhjetë e dy (32) janë anëtare të komunitetit Serb të Kosovës.



Shkaktarët dhe çështjet e nën-përfaqësimit të serbëve të Kosovës në profesionet ligjore të Kosovës

Serbët e Kosovës janë nën-përfaqësuar në pesë profesionet ligjore të Kosovës në masa të ndryshme. Ky nën-përfaqësim nuk mund t'i atribuohet vetëm një faktori në veçanti, por përkundrazi një sërë faktorësh individual për secilin profesion. Megjithatë, në të gjitha profesionet mund të gjenden çështje gjithëpërfshirëse që kanë ndikimin e vet.

Sipas Odës së Avokatëve të Kosovës, që është një organizatë vetëqeverisëse e avokatëve kosovarë e themeluar me Ligjin për Avokatinë dhe Ndihmën tjetër juridike, [16] nga 918 avokatë në Kosovë, 25 janë serbë të Kosovës. [17]Përderisa ky numër nuk është i papërfillshëm, tregon për përfaqësim të pamjaftueshëm të komunitetit Serb të Kosovës, të cilët vlerësohet se përbëjnë rreth 7.8% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Sidoqoftë, provimi i avokatit për kualifikim si avokat

[14] Ligji Nr.04 / L-193 për Avokatinë Gazeta Zyrtare e Kosovës / Nr. 20/31 maj 2013 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8673

[15] Regjistri i avokatëve në uebfaqen e Odës së Avokatëve të Kosovës http://www.oak-ks.org/sq/lista-e-avokateve

[16] Ligji Nr. 04 / L-193 Për Avokatinë, Gazeta Zyrtare e Kosovës / Nr. 20/31 qershor 2013, Prishtinë https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=187

[17] Intervistë me Florim Shefqetin, Drejtor Ekzekutiv i Odës së Avokatëve të Kosovës, datë 08/04/2019

brenda Kosovës ka një standard objektiv pavarësisht përkatësisë etnike apo diç të tillë. Prandaj, faktorët për pjesëmarrje më të ulët të Serbëve të Kosovës si avokatë janë më tepër indirekte.

Qëllimi kryesor i Odës së Avokatëve të Kosovës është promovimi i sundimit të ligjit në Kosovë dhe mbështetja e procesit të reformës. Ky profesion konsiderohet si zëri i profesionit juridik dhe vazhdimisht ndjek misionin e përmirësimit të drejtësisë. Oda ka zbatuar më parë projekte në koordinim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) duke krijuar vende për të përfunduar praktikën për studentë të drejtësisë/juridikut nga komunitetet pakicë, dhe vetë Oda ka marrë disa praktikantë serb të Kosovës vitet e fundit.

Nuk ekziston ndonjë pengesë ligjore që në ndonjë formë u pamundëson anëtarëve të komuniteteve të margjinalizuara që të aplikojnë dhe ta kalojnë provimin e avokatisë. Ky problem duhet të jetë për mungesë të interesit apo faktorëve të jashtëm që prekin qytetarët në të aplikuarit dhe ndjekjen e kësaj karriere. Oda e Avokatëve të Kosovës bashkërisht me OSBE-në kanë punuar në organizimin e trajnimeve të praktikantëve për të i përgatitur ata për të u bërë avokatë. Tri gjenerata të praktikantëve kanë përfituar nga këto trajnime. Kryesuesi i OAK-së thekson se edhe ata kanë pasur praktikantë që vinin prej komunitetit serb të Kosovës. Për më tepër, OAK ka një Komision të përhershëm për komunitetet që është tërësisht funksional. Në rekomandime do të përfshiheshin ngjarjet informuese dhe nxitëse për qytetarët dhe anëtarët e komuniteteve të marrin njohuri lidhur me profesionin. Kryesuesi i Odës së Avokatëve deklaroi se me financim të mirëfilltë ata do mund të zhvillojnë programe trajnimi që do të mirëprisnin këdo që është i interesuar për të u bërë avokat që të aplikoj dhe të bëhet pjesë e avokatisë.[18]

Pas intervistës me një avokat serb të Kosovës në Mitrovicë, u theksua një pengesë në atë që Komisioni për Verifikimin e Diplomave përjashton të gjithë të diplomuarit nga fakulteti juridik në Serbi, dhe si i tillë ata nuk mund të marrin një çertifikatë ose të aplikojnë për një vend pune në Kosovë. Përfaqësimi joadekuat i serbëve të Kosovës në profesionet ligjore duket se ndikon dhe shkakton emigrim të mëtejshëm të të rinjve që jetojnë në Kosovë.

Drejtori i Odës së Përmbaruesve Privatë të Kosovës beson se nëse do të kishte më shumë përmbarues privatë në qytete me përqindje më të lartë të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës, kjo do të kontribuonte në më shumë qasje në drejtësi dhe ndarje më të mirë të punës në komuna. Oda ka punuar së bashku me 'projektin e profesioneve të lira juridike' të financuar nga BE[19] për të prezantuar profesionet ligjore dhe për t'i inkurajuar qytetarët të përfshihen në këto profesione duke zhvilluar fushata ndërgjegjësimi në Mitrovicë dhe Zubin Potok. Gjatë këtyre

[18] Intervistë me Florim Shefqeti, Drejtori Ekzekutiv i OAK, me 08/04/2019

[19] Fillimi i projektit tonë: Mbështetje për profesionet e lira ligjore dhe Odën e Avokatëve në Kosovë https://www.bseurope.com/about-us/our-group/kick-our-project-support-free-legal-professions-and-bar-association-kosovo

vizitave informuese, dukej se kishte interes nga qytetarët por deri më tani Oda e përmbaruesve privatë nuk ka pranuar asnjë kërkesë nga anëtarët e komunitetit serb të Kosovës. Ai rekomandoi që pushteti vendor të jetë më i përfshirë në edukimin e qytetarëve për rëndësinë e këtyre profesioneve, i cili me sa duket do të çonte në shërbime të përmirësuara të ofruara nga përmbaruesit privatë.[20]

NDIKIMI

Ndikimi i nën-përfaqësimit të Serbëve në kuadër të profesioneve ligjore të Kosovës është i theksuar. Në tërësi kjo gjë flet për mungesë të pjesëmarrjes së komunitetit në jetën publike të Kosovës, duke u lënë në margjinalizim dhe ndarje të mëtejshme. Kjo gjë u vu në pah nga intervistat me palë të ndryshme të interesit.

Ky margjinalizim gjithashtu mund të përshpejtojë procesin e emigrimit të të rinjve serbë nga Kosova; pa perspektivë për punësim dhe margjinalizim në rritje shtohet stimulimi për të u zhvendosur në Serbi ose në vendet e tjera.

Sa i përket kësaj çështje ekziston nevoja për një zgjidhje që është jo vetëm gjithëpërfshirëse por edhe që drejtohet nga rinia.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përveç të dhënave, intervistat u zhvilluan me Odën e Përmbaruesve Privatë dhe Odën e Avokatëve të Kosovës. Ministria e Drejtësisë nuk iu është përgjigjur kërkesave tona. Po ashtu edhe anëtarët e komunitetit serb të Kosovës u intervistuan.

Kosova është shoqëri multi-etnike, dhe kjo larmi e shoqërisë kosovare duhet të pasqyrohet në të gjithë sektorët dhe profesionet. Ky duhet të jetë qëllimi dhe përkundër se mbetet akoma rrugë e gjatë për të arrirë deri atje megjithatë duhet ndërhyrë për të siguruar që kjo çështje të zgjidhet në një afat të shkurtër. Politikat dhe ligjet në Kosovë janë gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët e Kosovës por fatkeqësisht zbatimi është i dobët. Ne kemi gjetur se për shkak të shumë sfidave, komuniteti serb i Kosovës është shumë pak i përfaqësuar në profesionet e lira ligjore të Kosovës. Ekzistojnë shumë arsye pse kjo është një çështje, duke përfshirë edhe pengesën gjuhësore e cila është një nga pengesat më serioze për të hyrë në drejtësi.

Qeveria e Kosovës së bashku me shoqërinë civile duhet të punojnë së bashku për të hartuar një plan për përfshirjen e komunitetit serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera minoritare në të gjitha profesionet, duke përfshirë profesionet e lira ligjore. Ndërkohë, duhet të merren masat proaktive nga palët e interesuara përkatëse për të inkurajuar dhe nxitur pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës brenda komuniteteve. Prandaj, rekomandohen veprime konkrete si më poshtë:

[20] Intervistë me Arben Gashi, Drejtori Ekzekutiv i Odës së Përmbaruesve Privatë, më 25/04/2019

- Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e zbatimit të ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë. Po ashtu, duhet të ketë një planifikim më të mirë dhe kosto të zbatimit të tij.

- Njohja e diplomave duhet të jetë një çështje më e theksuar dhe të diskutohet në të gjitha nivelet.

- Krijimi i mundësive për të bërë praktikë para diplomimit dhe pas diplomimit që mundësojnë rritjen dhe përvojën profesionale për të rinjtë dhe juristët e ardhshëm me qëllim që ata të kenë mundësi të i nënshtrohen provimit të jurisprudencës. Si rezultat i kësaj ata do të stimuloheshin për të menduar po ashtu edhe për profesione tjera publike, siç janë noterët, përmbaruesit privatë, ndërmjetësuesit dhe administratorët e falimentimit. Komunikim të shtuar me publikun duhet të ndërmerret bashkërisht me trajnime pa pagesë për të sapo diplomuarit nga komuniteti serb i Kosovës po ashtu edhe për komunitetet e tjera jo-shumicë që janë të interesuar për të ndjekur këtë karrierë dhe për të u integruar në shoqërinë dhe fuqinë punëtore të Kosovës.

- Në kornizën legjislative çështja e gjuhës mbetet sfidë. Hartimi i ligjeve dhe politikave në Kosovë bëhet në të dy gjuhët zyrtare. Përkundër kësaj cilësia e përkthimit nuk është e njëjtë. Ka mospërputhje midis të dy versioneve dhe nganjëherë nene kontradiktore gjithashtu. Përpjekje të mëtejme dhe burime shtesë duhet bërë dhe siguruar ashtu që të mos ketë konflikt të ligjeve.

Meqë gjuha është dhe do të mbetet sfidë në Kosovë atëherë ekziston nevojë që të bëhen analiza për mënyrën se si të stimulohen si shqiptarët e Kosovës ashtu edhe serbet e Kosovës që ta mësojnë gjuhën e njëri tjetrit. Kapërcimi i pengesës gjuhësore do të marrë kohë dhe kjo është arsyeja pse duhet të jetë prioritet dhe të trajtohet më seriozisht. Që të gjithë duhet të inkurajohen të përdorin dhe flasin gjuhën e tyre, por në të njëjtën kohë duhet të ekzistojë mundësia për të mësuar secilin gjuhë të të tjerëve, pasi kjo do të rezultojë në një shoqëri shumë etnike që funksionon mbarë.

REFERENCAT

- Kuvendi i Kosovës, 26 Dhjetor 2018, Ligji Nr. 06 / L –010 Për Noterinë në Gazetën Zyrtare të Kosovës / Nr. 23, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18334
- Kuvendi i Kosovës, 13 nëntor 2013, Rregullorja Qrk-No. 31/2013 për Organizatën e Brendshme të Ministrisë së Drejtësisë, u miratua në mbledhjen 156 të qeverisë së Kosovës me vendimin nr. 01/156, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10360,
- Kuvendi i Kosovës, 2013, Rregullorja Qrk - Nr.12 / 2018 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Qrk-Nr. 31/2013 Për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/C9444161-1189-4794-AEEA-A69FD0181A19.pdf
- Kuvendi i Kosovës, 31 janar 2013, Ligji Nr. 04 / L-139on Procedura e përmbarimit Gazeta Zyrtare e Kosovës / Nr. 3 /, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870, ndryshuar dhe plotësuar në 2017, me Ligji Nr. 05 / L-118 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04 / L-139 Për Procedurën e përmbarimit, https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/69AEC87B-6E47-4CC0-A103-50E80C37011E.pdf
- Kuvendi i Kosovës, 20 gusht 2018, Ligji Nr. 06 / L –009 Për Ndërmjetësim në Gazetën Zyrtare të Kosovës / Nr. 14 / , https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17769
- Kuvendi i Kosovës, 7 korrik 2016, Ligji Nr. 05 / L - 083 Për Falimentimin / Nr. 23 /, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12664
- Kuvendi i Kosovës, 31 maj 2013, LIGJ Nr. 04 / L-193 PËR AVOKATINËhttps://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=187
- Kuvendi i Kosovës, 31 maj 2013, Ligji Nr.04 / L-193 për Avokatinë / Nr. 20 /, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8673
- Intervistë me Florim Shefqeti, Drejtori Ekzekutiv i OAK, me 08/04/2019
- Intervistë me Arben Gashi, Drejtori Ekzekutiv i Odës së Përmbaruesve Privatë, më 25/04/2019
- Anëtar i Grupit të Konsulencës GOPA, B&S, 11/22/2016, Fillimi i projektit tonë: Mbështetje për profesionet e lira ligjore dhe avokatinë në Kosovë, https://www.bseurope.com/about-us/our-group/kick-our-project-support-free-legal-professions-and-bar-association-kosovo

- Ministria e Drejtësisë së Kosovës, 6 qershor 2017, regjistri i ndërmjetësve në Kosovë, https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/0284D2EC-42BD-43DC-AE73-76C1DC8E74DC.pdf
- Ministria e Drejtësisë së Kosovës, 26 qershor 2018, regjistri i përmbaruesve privatë, https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/988243B5-9ABF-45CA-B3DB-7F53A905C237.pdf
- Ministria e Drejtësisë, vendimet e Ministrisë për Noteritë, https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,42



European Union Kosovo

ERAC
EQUAL RIGHTS FOR ALL COALITION